



RAPORTI VJETOR

PËR PUNËN E INSTITUTIT PARLAMENTAR PËR VITIN
2023

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	1
1. Shtëpi ligjvënëse e informuar	3
2. Kuvendi për të gjithë	6
3. Institut Parlamentar bashkëkohor	14
4. Parlament digjital	15

Përmbledhje

Në bazë të nenit 42 të Ligjit për Kuvendin dhe nenit 13 të Rregullores për punën dhe organizimin e Institutit Parlamentar, udhëheqësi i Institutit Parlamentar paraqet **Raport për punën për vitin 2023** para anëtarëve të Këshillit Drejtues. Në vitin 2023 Këshilli Drejtues mbajti **mbledhje më 30 janar 2023**.

Në funksion të informimit të deputetëve, në vitin 2023 janë përgjigjur **59 kërkesave të parashtruara**; ka përgatitur **32 hulumtime** me iniciativë; dhe iu përgjigj **113 pyetësorëve** për rrjetet ndërkombëtare dhe parlamentet e tjera. Fond shtesë informacioni u sigurua me **10 materiale referuese** nga biblioteka; janë dhënë **82 tituj**; **3 baza** të të dhënave të vëna në dispozicion; **78 abonime** në Gazetën Zyrtare; 8 gazeta dhe revista; seancë hyrëse për të punësuarit e rinj të Shërbimit; një **trajnim për asistentët** e grupeve parlamentare në Kuvend.

Në funksion të hapjes së Kuvendit dhe komunikimit me publikun mbi rolin e pushtetit ligjvënës, vlerat demokratike dhe kulturës politike janë zbatuar këto aktivitete:

Në vitin 2023, **10.245 qytetarë** ishin pjesë e **246 vizitave të organizuara** të Kuvendit nga 50 vende të ndryshme banimi në shtet, prej të cilave 23 qytete të ndryshme dhe 27 mjedise të ndryshme rurale.

Janë realizuar **22 seminare dhe punëtori edukative** gjithsej, kushtuar nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm, studentëve të universiteteve dhe mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm, me **gjithsej 717 pjesëmarrës**, ku morën pjesë **34 deputetë**. Më detajisht, janë realizuar: Një punëtori edukative **“Parlamenti i fëmijëve”**, kushtuar nxënësve të shkollave fillore; janë mbajtur 12 punëtori **“Kam qëndrim”** dhe në to kanë marrë pjesë **271 pjesëmarrës**; **tri seminare edukative njëditore**, me titull "Demokracia dhe Parlamenti"; **tri seminare për studentët** me titull pune "Parlamenti (Kuvendi) si institucioni themelor i të drejtës parlamentare"; **punëtori** me titull "Kuvendi dhe edukata qytetare për mësimdhënësit në shkolla"; punëtori për **gazetarët** dhe program për vullnetarët me **5 vullnetarë**.

Si aktivitete shtesë janë botuar dhe shpërndarë gjithsej **6505** materiale informative dhe promovuese; kalendari i **prodhuar në 500 kopje** për vitin 2024; Janë realizuar 8 aktivitete për shënimin e rasteve dhe **datave të rëndësishme**.

Për përfshirjen e grupeve të marginalizuara, në bashkëpunim me PPG-në u organizua një eveniment për të drejtat e personave me aftësi të veçanta dhe OJQ-në Inclusive nga Kumanova, ndërsa për herë të parë **për ditët e Frankofonisë u realizua manifestimi "Parlamenti i rinor i Frankofonisë - simulimi "Kam qëndrim"**.

Si pjesë integrale e Shërbimit të Kuvendit, Instituti Parlamentar koordinoi dhe dha kontribut në Planin aksional 2021-2023 për Partneritetin për qeverisje të hapur; Programin për mbështetje parlamentare dhe Planin strategjik të Kuvendit 2024-2028.

Zbatimi i të gjitha aktiviteteve të Institutit Parlamentar e kushtojnë rrogat shtetërore dhe kontributet për 20 të punësuar momentalisht. Nga shpenzimet operative dhe sipas buxhetit të

PËRMBLEDHJE

miratuar për vitin 2023, 400.000 denarë janë shpenzuar për udhëtim dhe akomodim jashtë vendit, mirëmbajtje softuerike dhe harduerike me dy kontrata 1.200.000 denarë, ushqime për vizitorë (kafe, ujë dhe ushqime) 860.000 denarë për 7000 denarë të tjera. shërbime kontraktuale (shtypje, përkthime, akses në baza të të dhënave etj.) ose gjithsej 0.5% të buxhetit vjetor të Kuvendit.

1. Shtëpi ligjvënese e informuar

1.1 Në vitin 2023 janë dorëzuar 59 kërkesa për hulumtime, nga të cilat 56 kërkesa janë parashtruar nga deputetët, ndërsa 3 kërkesa janë bërë nga sekretari i përgjithshëm. **56 kërkesat e realizuara për punime hulumtuese janë parashtruar nga 27 deputetë të ndryshëm gjithsej ose 22.5% e numrit të përgjithshëm të deputetëve.** Kërkesat e deputetëve në pjesën më të madhe lidhen me çështje të agjendës së Kuvendit.

Tabela 1. Statistika e hulumtimeve me kërkesë të deputetëve

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranura dhe të përgjigjura të dorëzuara nga deputetët				Numri i përgjithshëm i deputetëve që kanë dorëzuar kërkesë për hulumtim					
56				27					
Struktura gjinore	Numri i kërkesave nga deputetët		Numri i kërkesave nga deputetët		Struktura gjinore	deputete		deputetë	
	31	55,36%	25	44,64%		17	62,96%	10	37,04%
Përkatësia etnike	Numri i kërkesave nga deputetët maqedonas		Numri i kërkesave nga deputetët shqiptarë		Përkatësia etnike	Deputetë maqedonas		Deputetë shqiptarë	
	49	87,5%	7	12,5%		22	81,48%	5	18,52%
Përkatësia politike	Numri i kërkesave nga shumica parlamentare		Numri i kërkesave nga opozita		Përkatësia politike	Shumica parlamentare		Opozita	
	32	57,14%	24	42,86%		17	62,96%	10	37,04%

1.2 Me iniciativë personale Instituti Parlamentar ka përpiluar **32 punime hulumtuese**¹. Në punimet hulumtuese me vetiniciativë analizohen tema aktuale dhe tema që lidhen me propozim-ligjet që janë në procedurë kuvendore.

1.3 Mandej në periudhën raportuese janë përgjigjur **113 pyetësorë** në suazat e ECPRD-së, IPU-s dhe organizatave dhe parlamenteve të tjera.

¹Punimet hulumtuese me iniciativë personale janë në dispozicion të publikut në ueb-faqen e Kuvendit në linkun në vijim https://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut-ns_article-istrazuvaacki-raboti-po-sopstvena-inicijativa-na-parlamentarniot-institut-2021-godina.nsp

SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

- 1.4 Në suazat e aktiviteteve, Instituti Parlamentar mbajti **Trajnim hyrës për të punësuarit në Shërbimin e Kuvendit** si punëtori dyditore më 20 dhe 21 mars 2023, për 10 të punësuar të rinj me qëllim që të njihen me organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.
- 1.5 Më 26 dhe 27 janar Instituti Parlamentar organizoi dhe zbatoi **Trajnim për përforsim të kapaciteteve administrative të bashkëpunëtorëve të jashtëm të grupeve të deputetëve** me temë: “Përdorimi i sistemit të ri të E-parlamentit dhe rregullat nomoteknike të përpilimit të normativave” në të cilin morën pjesë 14 bashkëpunëtorë të jashtëm të grupeve parlamentare me qëllim që t’u ofrohen aspekteve të ndryshme të punës në Kuvend që të sigurohen shërbime cilësore, administrative, profesionale, teknike dhe të tjera për deputetët.
- 1.6 Për periudhën e raportit, Instituti Parlamentar për herë të parë realizoi **Program për vullnetarët** me qëllim që t’u mundësojë të rinjve të sapodiplomuar të fitojnë njohuri praktike për pushtetin ligjvënës. Puna vullnetare u realizua në periudhën **nga 15 maji deri më 15 nëntor 2023 me pesë kandidatë të përzgjedhur** në një proces përzgjedhjeje nëpërmjet shpalljes publike.
- 1.7 Pas procedurës së zbatuar për prokurim publik të gazetave ditore dhe javore më 03.11.2021 u lidh Marrëveshje me Shoqërinë për shpërndarje, tregti dhe shërbime Kolporter SHPK Shkup, në përputhje me të cilën Kuvendi i merr këto gazeta dhe revista (e njëjta pas procedurës së zbatuar është vazhduar deri në fund të vitit 2022 dhe 2023):
1. Nova Makedonija - 17 numra
 2. Veçer - 17 numra
 3. Sloboden pečat - 18 numra
 4. Lajm - 7 numra
 5. Koha - 8 numra
 6. Fokus (javore) - 17 numra
 7. Ekonomija i Biznis (mujore) - 2 numra
 8. Lice v lice (periodike) - 12 numra.
- 1.8 Kuvendi është abonuar dhe merr 10 ekzemplarë të botimit të shtypur të “Gazetës Zyrtare”. Për nevojat e deputetëve dhe të Shërbimit të Kuvendit, Instituti Parlamentar është abonuar dhe në tri baza të dhënash – Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Akademika dhe Praksis. Në bazën elektronike të të dhënave të “Gazetës Zyrtare” janë abonuar 49 përdorues deri më 10.02.2024, 29 përdorues deri më 14.8.2024.
- 1.9 Fondi bibliotekar është i unifikuar dhe është në dispozicion për deputetët dhe përdoruesit e tjerë. Janë përpunuar, regjistruar dhe futur në sistemin e-bibliotekës 14211 libra, të njëjtin janë shpërndarë në vitrinat në ambientet e Institutit Parlamentar dhe në korridoret e ndërtesës së Kuvendit. Siç ishte paraparë në vitin paraprak, librat nga salla “Boris Trajkovski” regjistrohen në sistemin elektronik të bibliotekës dhe vendosen në vitrina përkatëse dhe në përputhje me fushat e sistemuara dhe të sistemuara në dollapë. Numri i tyre është 1.701. Tek katalogu elektronik qasja është nëpërmjet faqes: < <http://biblioteka.sobranie.mk/General/Books.aspx>>, ku çdo përdorues mund të ketë qasje me emrin e vet të përdoruesit dhe me fjalëkalimin e vet me të cilin futet në sistemin e-parlament.

SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

1.10 Nga biblioteka gjatë vitit 2023 janë **huazuar 82 tituj**, prej të cilëve 3 libra janë huazuar nga deputetët.

1.11 Gjatë vitit 2023 janë përpiluar **dhjetë hulumtime tematike nga fondi bibliotekar** që e posedon biblioteka. Ato janë:

- Nobelues;
- E drejta korporative dhe financat
- Siguria;
- Krizat dhe ballafaqimet me to
- Procedura parlamentare
- Varfëri
- Sipërmarrje
- Farmakologji
- Gjeografi historike
- Produkte bujqësore ushqimore

Hulumtimet tematike janë në sistemin RMS të Institutit Parlamentar, në leximoren e bibliotekës hulumtuese si dhe në raftet nëpër ndërtesën e Kuvendit së bashku me materialet e tjera të Institutit Parlamentar.

2. Kuvendi për të gjithë

2.1 Në mbledhjen e Këshillit Drejtues më 30 janar 2020, janë propozuar dhe miratuar Plani vjetor për edukim dhe komunikim specifik me publikun për vitin 2023 dhe Plani vjetor për zbatim të trajnimeve nga Instituti Parlamentar për vitin 2023. Këto dy plane, janë baza e zbatimit të aktiviteteve për edukim dhe informim të qytetarëve, si edhe të deputetëve dhe të punësuarve në Shërbimin e Kuvendit, të bashkëpunëtorëve të jashtëm të grupeve parlamentare dhe të asistentëve në zyrat për komunikim me qytetarët.

2.2 Në përputhje me planet për edukim dhe komunikim specifik me publikun, Instituti Parlamentar gjatë vitit 2023 organizoi dhe zbatoi seminare dhe punëtori edukative për këto grupe qëllimore:

- dy punëtori edukative për nxënësit e shkollave nëntëvjeçare në Republikën e Maqedonisë së Veriut të quajtura “Parlamenti i fëmijëve”, gjithsej 150 pjesëmarrës, nxënës dhe arsimtarë.
- Katër seminare edukative njëditore, me temë “Demokracia dhe Kuvendi” për nxënësit e shkollave të mesme, gjithsej 104 pjesëmarrës, nxënës dhe arsimtarë;
- dhjetë punëtori edukative për nxënësit e shkollave të mesme në formë simulimi (lojë rolesh) të quajtura “Kam qëndrim!”, gjithsej 271 pjesëmarrës, nxënës nga 10 shkolla të mesme;
- Tri seminare interaktive njëditore për studentë me titull “Parlamenti (Kuvendi) si institucion themelor i të drejtës parlamentare” me gjithsej 81 studentë dhe profesorë;
- punëtori për arsimtarët për arsim qytetar nga shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjithsej 24 pjesëmarrës nga shkollat fillore;
- punëtori për gazetarët e akredituar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 pjesëmarrës gjithsej, gazetarë.

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur **22 punëtori dhe seminare edukative** kushtuar nxënësve të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, studentëve dhe mësuesve në arsimin nëntëvjeçar dhe të mesëm. Në eventet edukative me **717 pjesëmarrës gjithsej** u përfshinë edhe **34 deputetë nga parti të ndryshme politike**.

- Punëtorja edukative “Parlamenti i fëmijëve” - punëtorja e parë është organizuar onlajn më **24 shkurt 2023** dhe në të morën pjesë **72 nxënës gjithsej nga 15 shkolla nëntëvjeçare**, kurse e dyta u mbajt më **5 dhjetor 2023** (me rastin e Ditës Botërore të fëmijës) me **78 pjesëmarrës nga 15 shkolla nëntëvjeçare**. Qëllimi i këtij aktiviteti është që nëpërmjet simulimit të procedurës ligjvënëse të rinjve t’u afrohet puna e Kuvendit, të kontribuojë në zhvillimin e vetëdijes demokratike dhe kulturës së tolerancës, si edhe të nxiten të rinjtë për kritikizëm dhe përfshirje shoqërore dhe politike. Në këto punëtori **morën pjesë edhe gjashtë deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare** në Kuvend kështu që nxënësit kishin një mundësi jo të përditshme që të bisedojnë me deputetët dhe t’u parashirojnë pyetje.

KUVENDI PËR TË GJITHË

- Seminari edukativ “Demokracia dhe Parlamenti” - në seminarin e parë të mbajtur më **31 janar** morën pjesë **26 pjesëmarrës** nga 5 shkolla të mesme nga 4 qytete të ndryshme, në seminarin e dytë më **22 shkurt** nga 5 shkolla të mesme nga 5 qytete të ndryshme në një numër të përgjithshëm prej **28 pjesëmarrësish**, në seminarin e tretë më 7 mars morën pjesë **24 pjesëmarrës** nga 5 shkolla të mesme nga 4 qytete të ndryshme dhe në seminarin e fundit më 15 shtator me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë morën pjesë nxënës nga 5 shkolla të mesme nga 5 qytete të ndryshme me gjithsej **26 pjesëmarrës**.
- Punëtorja edukative “Kam Qëndrim!” - Punëtoritë në suazat e “Kam Qëndrim!” janë realizuar në një cikël, në periudhën nga **14 marsi deri më 12 prill** morën pjesë 10 shkolla të mesme me **271 pjesëmarrës** gjithsej. Simulimet e procedurës ligjvënëse të përfshirë në suazat e këtij aktiviteti i vlerësoi juri e përbërë nga tre deputetë, kurse në këtë sezon të “Kam qëndrim” morën pjesë **23 deputete dhe deputetë** gjithsej nga grupe të ndryshme parlamentare. Evenimenti final u mbajt më 2 maj, kurse fitues të këtij edicioni të “Kam qëndrim!” ishin nxënësit e shkollës “Rade Jovçevski - Korçagin” nga Shkupi.
- Seminari për studentët - tri seminarët me titull pune “Parlamenti (Kuvendi) si institucion themelor i të drejtës parlamentare” janë realizuar më **1 mars, më 3 maj dhe më 16 nëntor** dhe morën pjesë **81 studentë dhe profesorë gjithsej** nga 5 universitete të ndryshme. Në seminar morën pjesë edhe **tre deputetë** nga grupe të ndryshme parlamentare në Kuvend dhe studentëve ua përcollën përvojën e tyre praktike në kryerjen e funksionit parlamentar.
- Punëtorja për mësimdhënësit e arsimit qytetar të shkollë nëntëvjeçare- u mbajt më **5 tetor** me rastin e Dita Botërore të mësimdhënëseve dhe në të morën pjesë mësimdhënëse nga **24 shkolla nëntëvjeçare** nga i gjithë shteti nga **19 qytet dhe mjedise rurale të ndryshme**. Në punëtori morën pjesë edhe **tre deputetë** nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët janë anëtarë të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Sport.
- Punëtori për gazetarët e akredituar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt më **3 shkurt 2023** në Qendrën edukative të Instituti Parlamentar, me pjesëmarrjen e **13 gazetarëve** me temë: “Bazat e parlamentarizmit: teoria dhe praktika”.

2.3 Për të promovuar kulturën e hapjes së dhomës ligjvënëse, Instituti Parlamentar realizon **vizita të organizuara në ndërtesën e Kuvendit** për të gjithë qytetarët e interesuar. Në vitin 2023, **10.245 qytetarë** ishin pjesë e **246 vizitave të organizuara** në Kuvend. **Numri i vizitave të organizuara dhe numri i pjesëmarrësve në vitin 2023 është një arritje rekorde**, përkatësisht numri më i madh i vizitave dhe pjesëmarrësve deri më tani brenda një viti kalendarik. Vizitat e organizuara u realizuan me prani fizike të pjesëmarrësve në ndërtesën e Kuvendit. Nëpërmjet vizitave që zgjasin një orë, qytetarët kanë një mundësi të pazakontë për të parë ndërtesën e Kuvendit dhe për të parë se ku punojnë deputetët.

KUVENDI PËR TË GJITHË

Në lidhje me llojin e terminit vizitave, 9.067 (88.50%) pjesëmarrës ka pasur në vizitat me prani fizike të pjesëmarrësve, 385 (3.76%) pjesëmarrës në vizitat onlajn, ndërsa gjatë vizitave që mbahen në kuadër të seminareve/webinarëve edukativë kanë marrë pjesë 793 (7.74%) pjesëmarrës.

Tabela 2. Pasqyrë e pjesëmarrësve të vizitave sipas llojit të terminëve për vizitë në vitin 2023

Iloji i terminit për vizitë	numri i vizitave	numri i pjesëmarrësve
Vizita me prani fizike të vizitorëve	227	9.067
Vizita onlajn	5	385
Vizita të organizuara në kuadër të seminareve/webinareve edukative	24	793
Gjithsej	256	10.245



Sa u përket grupeve të synuara të përfshira me vizita, numri më i madh i pjesëmarrësve (6,176 ose pothuajse dy të tretat e numrit të përgjithshëm) ishin nxënës dhe mësimsdhënës të shkollave fillore. Nxënësit dhe mësimsdhënësit e shkollave të mesme kanë një peshë të madhe në numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve (1.711).

Tabela 3. Pasqyrë e pjesëmarrësve në Kuvend sipas llojit të pjesëmarrës në vitin 2023

Iloji i pjesëmarrësve	numri i vizitave	numri i vizitorëve
nxënës dhe mësimsdhënës të shkollave fillore	137	6.176
nxënës dhe mësimsdhënës të shkollave të mesme	37	1.711

KUVENDI PËR TË GJITHË

studentë	11	265
fëmijë dhe mësime nga mosha parashkollore	7	329
të ftuar të deputetëve dhe delegacione të huaja	9	247
grupe të anëtarëve të organizatave civile	14	557
të tjerë	41	960
Gjithsej	256	10.245



Në lidhje me gjuhën në të cilën janë realizuar vizitat, numri më i madh i vizitave kanë qenë në gjuhën maqedonase (74,55% nga numri i përgjithshëm), 47 kanë qenë në shqip (17.63%) 6 vizita kanë qenë në gjuhën maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe (7,72%), 12 vizita në anglisht (5,57%), kurse dy vizita kanë qenë në gjuhën maqedonase me interpretim në gjuhën e shenjave (0,9%).

Tabela 4. Pasqyrë e numrit të vizitave në vitin 2023 sipas gjuhës në të cilën janë mbajtur vizitat

Iloji i terminit për vizitë	numri i vizitorëve
në gjuhën maqedonase	7.491
në maqedonisht me përkthim në anglisht	305

KUVENDI PËR TË GJITHË

në gjuhën shqipe	1.806
në gjuhën angleze	571
në maqedonisht me përkthim në gjuhën e shenjave	53
në gjuhën serbe	3
në maqedonisht me përkthim në turke	16
Gjithsej	10.245




Sa i përket periudhës së vitit, më shumë pjesëmarrës gjatë vizitave janë vërejtur në muajt mars (1.402), maj (1.324) dhe nëntor (1.943), ndërsa më pak pjesëmarrës kanë pasur në muajt korrik (31) dhe gusht (15).

Tabela 5: Pasqyrë e numrit të vizitorëve në Kuvend në vitin 2023 sipas muajve

KUVENDI PËR TË GJITHË

Muaji:	numri i vizitave:	numri i vizitorëve:
Janar	7	209
Shkurt	21	747
Mars	36	1.402
Prill	24	1.116
Maj	34	1.324
Qershor	18	569
Korrik	3	31
Gusht	1	15
Shtator	23	901
Tetor	27	1.096
Nëntor	39	1.943
Dhjetor	23	892
GJITHSEJ :	256	10.245



KUVENDI PËR TË GJITHË

Në lidhje me përfaqësimin rajonal të vizitorëve në vitin 2023 Kuvendin e kanë vizituar qytetarë nga 50 vende të ndryshme banimi në shtet, prej të cilave 23 qytetet të ndryshme dhe 27 mjedise të ndryshme rurale prej të cilëve 385 pjesëmarrës onlajn.

- 2.4 Gjatë vitit u zbatua **përgatitja, shtypja dhe shpërndarja e vazhdueshme e materialeve të Institutit Parlamentar**. Në vitin 2023 janë **shtypur gjithsej 6.505 materiale promovuese dhe informative që u janë shpërndarë** grupeve përkatëse qëllimore.
- 2.5 Vizatimet dhe mesazhet e pjesëmarrësve në “Parlamentin e fëmijëve” të mbajtur në dhjetor janë përdorur për përpilimin e **kalendarit për vitin 2024**, i cili është shtypur në 500 ekzemplarë dhe është shpërndarë për promovim të Institutit Parlamentar dhe të pushtetit ligjvënës.
- 2.6 Në lidhje me **shfrytëzimin e mjeteve materiale, infrastrukturën elektronike dhe informatike**, shkallën e shfrytëzimit të **Qendrës edukative** për vitin 2023 është **34,78%** . Shfrytëzimi më i lartë ka qenë gjatë muajve tetor (86.88%, d.m.th. 139 nga gjithsej 160 orë pune) dhe nëntor (76.7%, d.m.th. 135 nga gjithsej 176 orë pune), ndërsa shfrytëzimi ishte më i ulët në muajt gusht (5,68 %, 10 orë nga gjithsej 176) dhe dhjetor (8,12%, d.m.th. 13 nga gjithsej 160 orë pune).
- 2.7 Në përputhje me Planin vjetor, Instituti Parlamentar bëri organizim dhe zbatim të **aktiviteteve për festimin e ngjarjeve dhe datave të rëndësishme**. Gjatë vitit 2023 janë festuar këto ngjarje dhe data të rëndësishme:
- **23 Prilli** - Dita Botërore e Librit dhe e së Drejtës së Autorit, e shënuar nëpërmjet ekspozitës së një pjese të përzgjedhur të fondit bibliotekar të Kuvendit, shkëmbimit të librave dhe dhënies së certifikatave mirënjohjeje për përdoruesit më aktivë të shërbimeve bibliotekare në Kuvend për vitin 2023.
 - **3 Maj** Dita Ndërkombëtare e Lirisë së Shtypit, për të drejtat e gazetarëve, u shënuar nëpërmjet seminarit edukativ të organizuar në Kuvend me studentë të Fakultetit Juridik nga Shkupi - Studime për Gazetari;
 - **30 qershor** Dita Ndërkombëtare e Parlamentarizmit– festohet nëpërmjet **aktiviteteve në rrjetet sociale**;
 - **12 gushti**: Dita Ndërkombëtare e të Rinjve - festohet nëpërmjet **aktiviteteve në rrjetet sociale**;
 - **15 Shtatori**: Dita Ndërkombëtare e Demokracisë - **seminar edukativ i organizuar** në Kuvend për nxënësit e shkollave të mesme;
 - **5 Tetor** Dita botërore e mësimdhënësve - **punëtori edukative e organizuar** në Kuvend me mësimdhënës të arsimit të mesëm;
 - **20 Nëntori**: Dita Botërore e Fëmijëve - **punëtori edukative e organizuar** në Kuvend për nxënësit e shkollave nëntëvjeçare më 5 dhjetor 2023;
 - **3 Dhjetori**: Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Veçanta dhe **10 dhjetori** - Dita e të Drejtave të Njeriut - Tryezë e rrumbullakët e organizuar me temë: “Pjesëmarrja politike e personave me aftësi të kufizuara” më 7 dhjetor 2023

- 2.8 Instituti Parlamentar në bashkëpunim me IPPG-në për të drejtat e personave me aftësi të veçanta dhe OJQ Inkluziva nga Kumanova, **më 7 dhjetor 2023** organizoi tryezë të rrumbullakët me titull pune: Pjesëmarrja politike e personave me aftësi të veçanta. Në këtë tryezë të rrumbullakët morën pjesë **gjashtë deputetë** dhe **21 përfaqësues** të disa organizatave të shoqërisë qytetare që merren me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Deputetët dhe pjesëmarrësit e tjerë patën mundësinë të ndjekin prezantim të dy analizave që i referohen vlerësimit të gjithëpërfshirjes së partive politike, si dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor.
- 2.9 Me rastin e Ditëve të Frankofonisë, Instituti Parlamentar, në bashkëpunim me MPJ dhe me Sektorin për bashkëpunim ndërkombëtar të Kuvendit realizoi për herë të parë evenimentin “Parlamenti rinor i Frankofonisë - simulim “Kam qëndrim!” më **21 mars 2023 viti i gjuhës franceze**. Në këtë eveniment morën pjesë **74** nxënës dhe mësimdhënës të shkollave të mesme nga Shkupi, Negotina, Manastiri, Gostivari dhe Tetova. Nxënësit diskutuan mbi tri tema të ndryshme në gjuhën franceze. Përveç kësaj, pjesëmarrësit e Parlamentit rinor të Frankofonisë e miratuan njëzëshëm “Deklaratën për përparimin e gjuhës franceze” që do të ketë ndikim të madh mbi përparimin e vendit dhe rolit të gjuhës franceze në sistemin arsimor dhe në hapësirën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- 2.10 Në periudhën raportuese, Instituti Parlamentar ka vazhduar me praktikën e vendosur **të raportimit të evenimenteve të tij** nëpërmjet mjeteve elektronike. Pas realizimit të çdo evenimenti, informacioni për të publikohet në faqet zyrtare të Institutit në rrjetet sociale, si dhe në faqen e internetit të Kuvendit.
- 2.11 Në kontekst të promovimit të hapjes, transparencës dhe llogaridhënies, Instituti Parlamentar vazhdimisht gjatë gjithë vitit i **publikoi punimet hulumtuese të përgatitura me iniciativën e tij për vitin 2023**, në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit. Ato gjenden në linkun e mëposhtëm: https://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut-ns_article-istravacki-raboti-po-sopstvena-inicijativa-na-parlamentarniot-institut-2023-godina.

3. Institut Parlamentar bashkëkohor

- 3.1 Instituti Parlamentar organizoi konferencën e gjashtë të **Forumit Ndërkombëtar të Qendrave Parlamentare të Vizitorëve**, e cila u mbajt në Shkup nga **26 deri më 29 shtator 2023**, me temën **“Ndryshimi, përshtatja, evolucioni - si të qëndroni relevant në një mjedis dinamik dhe gjithnjë në ndryshim”**.

Në Forum, i cili synon promovimin e hapjes së parlamenteve dhe përforcimin e bashkëpunimit parlamentar ndërkombëtar në fushën e informimit dhe edukimit të publikut, morën pjesë **45 pjesëmarrës nga 19 parlamente kombëtare nga e gjithë bota**.

Pjesa e punës në këtë forum përmbante një seri sesionesh për shkëmbim të përvojave dhe zbatimin e praktikave më të mira midis pjesëmarrësve. Këto sesione mbuluan aspekte të ndryshme të cilat lidhen me punën e qendrave të vizitorëve siç janë evaluimi dhe rëndësia e informacioneve kthyesë, edukimi (jo)formal politik, si dhe shkëmbimi i aktiviteteve dhe produkteve inovative. Gjithashtu vizitorët kishin mundësi ta ndjekin edicionin special të aktivitetit edukativ **“Kam qëndrim!”**, i cili për herë të parë u mbajt në gjuhën angleze. Në këtë forum u ftuan si ligjërues edhe profesorë universitarë nga UKEM.

- 3.2 Gjashtë të punësuar e shfrytëzojnë mundësinë për ngritje profesionale, tre të punësuar në studime pasuniversitare, dy të punësuar në studime të doktoratës dhe një e punësuar për trajnim të specializuar.
- 3.3 Për të matur **shkallën e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve** të Institutit Parlamentar, kryhet **evaluim i evenimenteve edukative** pas përfundimit të tyre, mandej përpilohet **Analizë e evaluimit dhe Raport me përfundime dhe rekomandime**, të cilat merren parasysh gjatë përpilimit të Planit vjetor dhe gjatë revizionit të programeve të evenimenteve edukative.
- 3.4 Në periudhën raportuese, vazhdoi bashkëpunimi onlajn i Institutit Parlamentar në kuadër të **Federatës Ndërkombëtare dhe Asociacionit të Bibliotekave IFLA, Këshillit Ndërkombëtarë të Arkivave (ICA), Forumit Ndërkombëtarë të Qendrave Parlamentare për Qasjen e Parlamenteve dhe Qendrës Evropiane për Hulumtime Parlamentare dhe Dokumentim (ECPRD)**.
- 3.5 Në bashkëpunim me qendrën hulumtuese të Dhomës së Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar dhe Universitetin në Lids, **Instituti Parlamentar u bë anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar për Aksion Parlamentar <https://ipen-network.org/>** qëllimi i të cilës është zhvillimi i rrjetit ndërkombëtar të ekspertëve dhe profesionalistëve në lidhje me efikasitetin dhe ndikimin e programeve për përfshirje të publikut në parlamente.

4. Parlament digjital

- 4.1 Instituti Parlamentar ka në dispozicion platforma softuerike për disa procese pune: E-arkivi, E-biblioteka dhe RMS, e-sistemet për regjistrimin e qytetarëve, kuiz edukativ, vizitë virtuale, E-seminare dhe E-trajnime. Mandej, të punësuarit përdorin licenca për programet canva dhe abode për përpunim grafik. Të gjitha sistemet ishin lëndë e mirëmbajtjes parandaluese. Nëpërmjet këtyre shërbimeve bëhet mirëmbajtje cilësore dhe në kohë e zgjidhjeve të zbatueshme dhe bazave të të dhënave të sistemit informativ.
- 4.2 Në suazat e Programit PSP, kuvendi më 11.09.2023 me numër 02-4153/3 ka marrë 30 kompjuterë të rinj desktop për nevojat e Institutit Parlamentar. Të gjithë u janë dhënë të punësuarve për përdorim.
- 4.3 Gjithashtu, Kuvendi pranoi të lidhë marrëveshje ndërmjet NDI-së si donator fondesh dhe Arkivit Shtetëror për skanimin dhe indeksimin e dokumenteve arkivore nga arkivi legjislativ në softuerin në pronësi të Institutit Parlamentar në Kuvend. Marrëveshja është lidhur më 15 gusht 2023 në vlerë prej 420.600 denarësh për të skanuar dhe indeksuar 102 kuti arkivore nga mandati 2011-2014. Skanimi i dokumenteve ka përfunduar, në vijim është vendosja në zgjidhjen softuerike, për të cilën në ambientet e Institutit Parlamentar është angazhuar një grup prej 8 të punësuarish nga Arkivi i Shtetit për të indeksuar dokumentet nga arkivi legjislativ.

Zllatko Atanasov

Këshilltar shtetëror - udhëheqës i Institutit Parlamentar